

Dorëheqjet e Jankullovskës dhe Mijallkovit kanë pasuar pas një takimi që ata kanë pasur të hënën në mbrëmje në ambasadën amerikane në Shkup, raporton portali Libertas.

Sipas burimeve të afërta me ambasadën, në këtë takim Jankullovskës dhe Mijallkovit u janë dhënë regjistrime (incizime) nga kontaktet telefonike midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundëzbulimit (DSK) me grupin e komandant NATO dhe njerëzit e tij.

Siç thuhet më tej, aty u është dëshmuar përfshirja e DSK-së, e cila ka biseduar me grupin e armatosur në Kumanovë.

“Shqiptarë të punësuar në DSK kanë kontaktuar përmes telefonit me grupin, duke thënë se ata kanë kontaktuar me urdhër direkt të shefit të DSK-së, i cili ka pyetur se çfarë kompensimi kërkojnë që të tërhiqen. Praktikisht MPB ka hyrë në bisedime me ta”, thotë burimi i Libertasit.

Paralelisht me këtë, edhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, në marrëveshje me partnerët e koalicionit ka kërkuar ndihmë nga OSBE për të tërhequr tre persona të afërt me të që ishin pjesë e grupit, që më pas të negocion me ta.

“Gjatë takimit të sotëm në ambasadën amerikane, edhe Ahmetit iu bë e ditur se komuniteti ndërkombëtar përmes këtyre incizimeve e ka të qartë edhe përfshirjen e Qeverisë në ngjarjet në Kumanovë dhe se aksionin e përgjakshëm MPB-ja e filloi kur veçse në terren kishin humbur jetën disa pjesëtarë të forcave policore”, bën të ditur burimi.

“Dorëheqjet që ndodhin sonte janë logjike pas takimeve të sotme mes ambasadorëve dhe zyrtarëve”, ka thënë burimi diplomatik, duke mos e bërë të qartë nëse edhe kryeministri Gruevski së shpejti do të japë dorëheqje, edhe pse sipas burimit ai ka pasur informatat për kontaktet e kushëririt të tij me grupin kriminal. (Libertas/INA)